

Programi i: Konkureshmëria dhe sipërmarrja

Pse konkureshmëria dhe sipërmarrja ne fokus

Produktiviteti në UniBa është një faktor kryesor që ushqen rritjen ekonomike dhe mirëqënien nëpërmjet nivelit të pagave. Evidenca empirike dhe eksperiencat praktike të ekonomive në zhvillim dhe të zhvilluara, dëshmojnë dhe zhvillojnë idenë që konkureshmëria dhe produktiviteti janë të pandashëm dhe që konkureshmëria përkthehet në rritje dhe lulëzim ekonomik e shoqëror, në sipërmarrje dhe novacion

Nga konkureshmëria përfitojnë të gjithë aktorët bizneset dhe konsumatorët, qeveria dhe shoqëria. Përfitimi më i dukshëm është lulëzimi i inovacionit (risive dhe shpikjeve).

Midis të tjerave konkureshmëria është e lidhur ngushtë me institucionet, infrastrukturen dhe ambientin makro e mikro ekonomik, shoqëror e politik. Nxitja dhe mbështetja e konkureshmërisë ushqen inovacionin, cilësinë e produkteve dhe krijon hapësira e mundësi të shumta, pra krijon dhe rrit sipërmarrjen.

Janë përpiluar modele të ndryshme zhvillimi për të zhvilluar sipërmarrjen dhe novacionin që rrisin konkureshmërinë në nivele të ndryshme hapsinore dhe jo.

Një ndër ta është i ashtuquajtimi modeli shumë dimensional, helika e pesëfishte (Quintuple Helix –QH- model krijuar nga Carayannis & Campbell - 2009). Sipas modelit QH mundësia për novacion dhe zhvillim ekonomik në një shoqëri dijetar, qëndron në rolin e vecante të universiteteve që në bashkëpunim me industrinë dhe qeverinë gjenerojnë formate të reja institucionale dhe shoqërore për prodhimin, transferimin dhe aplikimin e njohurive.

Bazuar në keto paraqitje konceptuale të modeleve bashkëkohore të zhvillimit, Grupi Barleti ndër objektivat e tij, ka si busull orientuese, për pjesën e edukimit, **konceptin e Universiteti Sipermarres**.

Modeli frymezues i këtij programi është **Modeli iHelikës së Pesëfishte (Quintuple Helix - QH)**.

Përdorimi i modelit QH nxitet së fundmi dhe nga strategjia e BE për novacion: “European Union Research and Innovation Startegies for Smart Specialisation” i quajtur RIS3. Referuar analizave të rasteve të ekonomive nordike të suksesshme, sipas kësaj strategjie, duket që në bazë të saj qëndron modeli QH, i zbatuar në këtë rast, duke theksuar lidhjet midis novacionit dhe njohurive, produktivitetit të novacionit dhe konkureshmërisë.

Sipas modelit QH, roli i sipërmarrjes dhe konkureshmërisë në zhvillimin ekonomik është thelbësor dhe nxit ekonomitë të kalojnë nga një stad zhvillimi në tjetrin: nga ekonomi të drejtuara nga faktorë - në ekonomi të drejtuara nga eficienta dhe më tej, në ekonomi të drejtuara nga novacioni. Roli i pesë aktorëve veprues të modelit si: universitete-industri-qeveri-shoqëri-qytetar e ambient, faktorizohet në mënyra të ndryshme duke dalluar faktin që: a) **në ekonomitë industriale** me pak të zhvilluara industria ka rol përcaktues, b) **ekonomitë e eficientës** të pestë aktorët janë të ekuilibruar, dhe c) **ekonomitë novatore**, ku përparësi merr biznesi dhe ku qeveria



vetëm mbështet, pra ekonomitë e novacionit. Kjo sepse novacioni është i domosdoshëm dhe pjellë e një ambienti me konkurueshmëri në rritje.

Roli i aktorëve – shoqëri dhe ambjent, në modelin QH, qëndron në faktin që thekson edhe një herë bashkëpunimin midis universiteteve, sektorit të biznesit, qeverisë, shoqërisë civile e organizmave ndërkombëtarë në mbrojtje të ambientit dhe vlerave shoqërore, që mbështesin rritjen e krijueshmërisë të sipërmarrësve të cdo lloji duke zhvilluar edhe industritë krijuese. Ky bashkëpunim kthehet në forcë drejtuese që gjeneron krijueshmëri, ide, cilësi, aftësi e njohuri.

Si i tillë, ky model jep një mënyre të re, komplekse dhe sfiduese duke thyer barrierat mes biznesit, qeverisë, akademisë dhe shoqërisë civile (e parë si shoqëri mediatike, kulturore, ambientaliste) dhe duke krijuar kështu një përjasje të re, shumëdimensionale, në një ambient që promovon grupin, bashkëpunimin dhe këmbimin e ideve. Duke punuar së toku, këta aktore, në modelin QH krijojnë vlera të reja që ndahen nga të gjithë a nga të cilat përfitojnë të gjithë. Ky është ekosistemi novativ ku teknologjia krijon lidhje dhe rrjetëzime, duke përmirësuar kushtet shoqërore dhe ambientin, si dhe performancën e kompanive, qeverisë dhe individëve. Suksesi në këte rast, matet në tërësi, për të gjithë ekosistemin, jo vetëm për njësitë individuale.

Në këtë kornizë zhvillimi aktual e bashkëkohor, programi përfaqësohet në katër nivele:

- a) rajonal (vende të ndryshme së toku në iniciativa të përbashkëta inovacioni e sipërmarrjeje)
- b) kombëtar (qeveria ndërmerr politika, programe, projekte, iniciativa në nivel kombëtar)
- c) qyteti (qeveria vendore si bashkitë e ndryshme ndërmarrin në nivel lokal politika, programe etj)
- d) operator (institucione të arsimit të lartë, sipërmarrjet, organizma, instrumente, iniciativa si akseleratorët, co-working space, inkubatorët etj)

I. Konteksi në nivel rajonal

Konkurueshmëria dhe sipërmarrja, janë leva shumë të rëndësishme të zhvillimit rajonal.

Ndryshimet e mëdha në ambientin ekonomik global kanë sjellë ndryshime në ekonomitë e vendeve të Ballkanit. Edhe pse nën shtrëngesa politike, këto ndryshime globale ekonomike kanë sjellë si detyrim të menjëhershëm eliminimin e kufijve për të lehtësuar këmbimin dhe lëvizjen e informacionit, njerëzve, turizmit, aseteve financiare etj. Bizneset dhe aktorët e tjerë, janë të motivuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë nga ekonomia e shkallës, madhësia e tregut, eksperiencat dhe aftësitë e njëri tjetrit. Pra si rezultat, janë krijuar politika zhvillimi të përbashkëta, aleanca ekonomike e politike, në nivele makro e mikro, (duke krijuar parqe inovacioni, teknike, e shkence), për të arritur zhvillim të shpejtë dhe konkurrenca ekonomike rajonale.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor si një nga rajonet më pak të zhvilluara në Evropë, është përballur vazhdimisht përgjatë historisë së tij me pengesa e probleme të shumta përvoja të përkohshme zhvillimit ekonomik e atij politik në veçanti. Konkurenca e brishtë dhe shpesh e munguar, sipërmarrja me



tendencë të fortë zhvillimi por në nivel konkurrueshmërie globale akoma të ulët, inovacioni dhe sipërmarrja si pjesë e zinxhirit të gjate të zhvillimit, janë si thembra e Akilit, për të kapërcyer sfidat rajonale si në ekonomi, politike e shoqëri.

Konkurueshmëria dhe sipërmarrja në rajon zhvillohet në forma e me mjete të ndryshme që programi konsideron në perberje të tij, si rruge për arritjen e qëllimit përfundimtar, përgatitjen e kapaciteteve njerëzore, institucionale dhe të dijeve, njëambjent konkurrues dhe pjellor për sipërmarrjen në shumë dimensione.

II. Konteksti në nivel kombëtar

Institucionet e shumta ndërkombëtare janë të përfshira në matjen e konkurrencës kombëtare në mbarë botën dhe në rajon gjithashtu. Një nga treguesit më të zakonshëm të konkurrencës e të konsideruar nga aktorët e interesuar është sigurisht ajo e dhëne në raportet "Doing business" të publikuara nga Banka Botërore dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare IFC. IBRD, Forumi Ekonomik e Davosit etj.

Niveli i konkurrencës kombëtare varet nga produktiviteti kombëtar, që është rezultat i zhvillimit ekonomik të një vendi të caktuar. Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të vijë si pasojë e bashkëpunimit të frutshëm të aktorëve akademi, industri, qeveri dhe shoqëri civile nën filozofinë e QH

III. Konteksti në nivel qyteti

Pushteti vendor i nëndarjeve administrative të ndryshme përfshirë qytetin, zhvillojnë politika dhe programe për rritjen e kapaciteteve lokale për të mirëpritur, krijuar dhe përmirësuar ambjentet për aktivitete të ndryshme që mbështesin sipërmarrjen dhe inovacionin duke përmirësuar konkurrueshmërinë si startup-e, hakathrone, akseleratorë, inkubatore, co-working space etj. Në nivel lokal punohet për krijimin dhe zhvillimin e ekosistemit: si krijimin e ekipeve të specializuara për mbështetjen e sipërmarrjes dhe rritjen e konkurrueshmërisë, për identifikimin e talenteve të reja sipërmarrëse si dhe për iniciativa të ndryshme mbështetëse. Për këtë nevojiten kapacitete përkatëse lokale njerëzore, institucionale dhe hapsinore që duke krijuar lidhje me pushtetin qëndror e pushtete të tjera lokale kur duhet, rrisin terheqjen dhe bashkëpunimin me investitorët, universitetet, kompanitë, organizatat shoqërore, ambientaliste, etj.

IV. Konteksti në nivel operatorësh

Që konkurrueshmëria të rritet e zhvillohet më bazë të fortë, kërkohen kapacitete njerëzore, institucionale e hapsinore në shumë nivele, sidomos në nivel baze, në ato të operatorëve të vecante. Si nivel operatorësh konsiderohen universiteti me burimet e dijes dhe burimet njerëzore që ka në pronësi dhe që nxjerr si produkt të tij, sipërmarrjet si LAB-e të universitetit, partnerët dhe klientët e produkteve të tij, akseleratorët, co-working space, struktura publike e private si hapësira dhe institucione në mbështetje të frymës sipërmarrëse në cdo hallkë, përfshirë dhe sipërmarrjen vetë.



Në këtë nivel Grup Barleti, vendos në qendër dhe projektton UniBa-n, si **Universitet Sipërmarrës** prandaj ky program vendos UniBa-në në baza të reja novative zhvillimi, duke ofruar programe dhe të diplomuar më aftësi zbatuese dhe sipërmarrëse, jo vetëm akademike por edhe praktike. Kjo krijon një avantazh konkurrenës të UniBa-së në tregun e institucioneve të edukimit të lartë.

Bazuar në modelet bashkëkohore të zhvillimit, si QH, UniBa ka vendosur objektivat e tij për pjesën e edukimit zhvillimin e:

Konceptit të Universitetit Sipërmarrës. Në këtë perspektivë UniBa formatohet si vijon;

- Ai merr një rol proaktiv duke vënë njohurinë në një pozicion të ri, - njohurinë në përdorim për të krijuar njohuri të reja të domosdoshme, për të arritur sipërmarrjen në një ambient të lartë konkurrence. Nderkohë që biznesi në zhvillim të vazhdueshëm, ngrë nivelin teknologjik dhe rrit kërkesën për dije dhe aftësi të reja, qeveria del në rolin e sipërmarrësit publik dhe të financuesit-venture kapitalist. Kështu novacioni i dalë nga korniza e brendshme e ndërmarrjes është kthyer në një aktivitet gjithëpërfshirës ku ben pjesë dhe universiteti, që fillon e luan një rol aktive në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik.
- Universiteti sipërmarrës, si i tillë, nxit kapacitetet dhe talentet e studenteve për ide të reja, për sipërmarrje të reja, për t'u bërë punë-krijues e punëdhënës jo vetëm punëmarrës pasiv, në tregun e punës. Universiteti sipërmarrës edukon jo vetëm individët por dhe organizatat e ndryshme nëpërmjet programeve të pasur e komplekse të sipërmarrjes, në hapësira të reja si parqe teknologjike e shkencore, inkubatore, co-lab, venture kapital etj.
- Universiteti sipërmarrës duke gjeneruar teknologji të re, kthehet nga vetëm burim i kapaciteteve njerëzore dhe dijeve, në burim të gjenerimit dhe transferimit të teknologjisë së re.
- Pra, universiteti sipërmarrës është një burim në rritje i zhvillimit ekonomik rajonal/kombëtar/qytetar/individual.

Si i tillë, UniBa zhvillon dhe mbështet programe bashkëkohore të niveleve të ndryshme përfshirë dhe ato profesionale, që edukojnë aftësi e cilësi sipërmarrëse. Ata mbështesin format e reja të zhvillimit, iniciativat, produktet si startup-et, spin-off, e shumë të tjera që përgatisin jo vetëm specialistë por krijues e drejtues biznesesh, lojtarë aktivë në zhvillimet shoqërore e ekonomike të vendit e më përtej në një ekosistem të zhvilluar me kujdes e cilësi, si pjesë e pandashme e këtij universiteti.

Drejtimet konceptuale kryesore ku programi mbështetet ravijëzohen si vijon:

- Biznese konkurruese (competitive SME)
- Startup-në nivele të ndryshme: rajonal/kombëtar/qyteti/ekosistemi apo operatorësh
- Inovacion shumë dimensional (Open Innovation)
- Ekonomi e bazuar në dije (Knowledge based Economy)
- E ardhmja dixhitale etj (Digital Future)



Biznese konkurruese (competitive SME)

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë jetike për ekonominë e BE-së duke përfaqësuar 99% të biznesit evropian dhe 2/3 e punësimit të sektorit privat. Fondi Evropian strukturor dhe Fondi i Investimeve që nga viti 2014-2020 kanë vënë në dispozicion më shumë se 450 miliardë euro për vendet antare për të financuar investimet që mbështesin punësimin dhe rritjen ekonomike të vendeve. Edhe në Shqipëri roli i tyre është po aq jetik dhe i rëndësishëm, dhe rritet më tej në suazën e integritimit evropian që hap perspektivat e tij me hapjen e negociatave. Prandaj, në programin e Sipërmarrjes dhe Konkurrueshmërisë targetohet aftësimi i burimeve njerëzore përkatëse, për me tepër:

- akses në financime, grante e fonde të ndryshme
- mbështetje biznesi me (know-how) njohuri, këshillim, informacion, network, partneritete etj.
- mbështetje për akses në tregje rajonale e ndërkombëtare
- burime të reja rritjeje si ekonomi e gjelbër, turizëm i qëndrueshëm, shërbime shëndetësore e sociale, industri kulturore e krijuese
- investime në kapital njerëzor si trajnime dhe edukime profesionale
- lidhje e bashkëpunime me qendrat e kërkimit, universitetet për të promovuar inovacionin
- krijim e mbështetje për start-up etj

Startup në nivele të ndryshme: rajonal/kombëtar/qyteti/ekosistemi apo operatorësh

Mos lejoni që zurma e opinioneve të tjerëve të mbysë zërin tuaj të brendshëm. Dhe më e rëndësishmja, kini kurajën të ndiqni zemrën dhe intuitën tuaj.” ka thënë Steve Jobs.

UniBa dhe strukturat e tjera të ngjashme e të përditesuara, ju japin zë, ideve të reja, novative e sipërmarrëse, nëpërmjet aktiviteteve të larmishme si ato të startup-eve, akseleratorëve, inkubatorëve, spin-off etj, në nivele të ndryshme. Zhvillimi i tyre nëpërmjet aktiviteteve që nxisin zhvillimin dhe pjekjen e ideve të biznesit në faza të ndryshme të tyre shërben si djep i sipërmarrjes sëpergatitur për konkurrencë të të gjitha niveleve, lokale, kombëtare, rajonale dhe globale. Nëpërmjet tyre, spikasin dhe zhvillohen aktivitete si:

- koha për të filluar të zhvillosh idenë nëpërmjet startup-eve weekend-eve
- mbështetje më këshillim, mentorship, inovacion të hapur, biznes-plan, akseleratorë, lidhje rajonale e pjesëmarrje në konkurse të niveleve të ndryshme
- prezantim e lidhje me investitorët potenciale si engjëjt, crowd funding, grantet e ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, equity financing etj.
- Infrastrukturë si HUBs and LABs nën konceptin puno-jeto-mëso, inkubatorë, logjistikë, parqe industriale, co-working space, parqe teknologjike, etj

Novacion shumë dimensional dhe i hapur



Sipas Henry Chesbrough, njohur si babai i novacionit të hapur, ky i fundit perkufizohet në librin e tij si; "një domosdoshmëri e re për të krijuar dhe perfituar nga teknologjia". Këmbimi i njohurive sipas tij, sjell përshpejtim të brendshëm të inovacionit dhe zgjeron tregjet për përdorim të jashtëm të këtij novacioni.

Programi mbështet novacionin e hapur duke prezantuar dhe mbështetur modelet në nivele të ndryshme, brenda një kompanie apo grupeve të një kompanie dhe sipërmarrësve në një anë dhe kompanive e konsumatoreve në anën tjetër. Instrumentet e përdorur për këtë qëllim janë:

- akseleratorët që ndihmojnë start-up-et në nivele qyteti, kombëtar apo më përtej;
- modelet që vendosin konsumatorët në zëmër të procesit të prodhimit duke marrë ide nga jashtë, vlerësuar dhe përdoruar më tej në linja të reja produkti;
- ndërtimin e platformave co-krijuese që ndihmojnë në zvogëlimin e rrezikut të inovacionit sepse feedback-u, reagimi nga web-et, i jep analistëve ide se si perceptohet produkti i ri.

Ekonomia e bazuar në dije dhe njohuri (Knowledge based Economy)

"Ekonomia e bazuar në njohuri" nënkupton përdorimin e njohurive për të krijuar vlera të prekshme e te paprekshme. Teknologjia dhe veçanërisht teknologjia e njohurive, ndihmon mishërimin e dijeve njerëzore në makina. Kjo njohuri e përdorur nga sistemet vendimmarrëse, gjeneron vlera ekonomike si për individët, bizneset e shoqërinë. Njohuria është faktori kryesor në rritjen ekonomike, në perballimin e konkurrencës së sukseseshme, në zhvillimin e sipërmarrjes dhe novacionit, në qytete, shtete, ekonominë në tërësi. Këtë njohuri ushqen UniBa me programet dhe aktivitetet e tij.

E ardhmja dixhitale

Programi përdor dhe mbështet gjithashtu përgatitjen e kapitalit njerëzor për të ardhmen dixhitale. Ajo tashmë ka filluar dhe bota e punës e biznesit ka ndryshuar kodo me shpejtësi marramendëse. Secili kur vlerëson pozicionin e tij në tregun përkatës, duhet të njohë e zotërojë teknologjitë e reja në fushën përkatëse dhe në përfitimin e shërbimeve në mënyre të tillë që t'i përvetësojë dhe përdorë ashtu sic ka kuptuar e verbalizuar me gjenialitet që shumë kohë më parë dhe Anshtajni: "Të mësuarit është një eksperiencë, cdo gjë tjetër është informacion".

Kjo është deviza bashkëkohore e novacionit të hapur edhe sot nga e cila udhëhiqet UniBa në punën kërkimore të tij. Njohja me industrinë ku punohet, fushën e ngushtë të specializimit, lidhjet me partnerët dhe konkuresit, klientët etj janë variabla të levizshëm që duhen vlerësuar e përditësuar vazhdimisht e në mënyrë të pandërprerë që të jesh konkures në treg e të ushqesh sipërmarrjen me dijen e kërkimit. Kërkimi në UniBa, mbështetet në konceptin që:

Të menduarit strategjik dhe intelekti i trajnuar për të reja e shkencës, teknologjisë dhe praktikës, janë aftësi të domosdoshme në të ardhmen dixhitale që duhen edukuar, përvetësuar e përdoruar sot. Po ashtu specializimet e reja në ndryshim të vazhdueshëm të diktuar nga zhvillimi i vrullshëm dhe i pandalshëm i teknologjive të reja, transferohen e bëhen pjesë e përgatitjes së punonjësve të së ardhmes.



Duke mbajtur parasysh që e ardhmja dixhitale nënkupton që të gjitha bizneset do të operojnë në mënyre dixhitale në të ardhmen, UniBa fokuson punën kërkimore dhe zhvillimore në të. Stadi aktual i sotëm i zhvillimit të kapaciteteve njerëzore e teknologjike emërtohen si ambient dixhital. (ambient ku ndërliiden pajisje, objekte, makina, të aftë të transferojnë të dhëna nëpër rrjete dhe pa ndërveprim njëzëz të drejtpërdrejtë). Kjo vihet në zbatim, gjithnjë e më shumë në sistemin bankar dhe të shërbimeve financiare, në shitjet me pakicë, në telekom, udhëtime, shërbime në familje etj, si ndezja e sistemit ngrohës nga distanca pa hyrë në shtëpi akoma, apo komandimi i garazhit etj etj, prandaj programi kërkimor në UniBa, përqëndrohet nëkëtë faktor zhvillimi. Cdo biznes po ndërton të ardhmen dixhitale të bazuar në një bashkëveprim të përhershëm me cdo klient. Ata e dinë që duhet të ofrojnë eksperiencë të personalizuar bazuar në aktualitetin e aktivitetit të klientit, historinë, statusin, motivet e aspiratat më të fundit. Faktorët që ndihmojnë kompanitë të ecin në linjë me të ardhmen dixhitale janë sipas rendësisë: kultura e kompanisë, mbështetja nga manaxherët, partnerët teknologjikë, buxhete të qartë e të saktë, punonjës të ditur, vizion drejtuesish të lartë, etj që hulumtohen, zhvillohen e sjellin novacione në UniBa. Për këto zhvillime, kërkimi krijon ndërjegjësim e trajnim nëpërmjet këtij programi.

Sektorët ku përqëndrohen drejtimet kryesore të programit sipas niveleve përkatëse janë:

- sektori i shërbimeve mbështetëse,
- industritë krijuese dhe kultura,
- turizmi dhe sektorët e lidhur me të,
- smart city,
- e-shëndet dhe e –qeverisje,
- agroushqimor